

Akt Themelimi

i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“Meçe Plast” SH.P.K

Neni 1 Formimi

Sot më datë 16/04/2024 themeluesit që firmosin më poshtë:

1. **Festim Meçe**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 07.09.1951 , lindur në Korce, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. F109070350

Në bazë të Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe Ligjit Nr.9723, dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” themelojme me vullnetin tone të lirë Shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “Meço” sh.p.k

Neni 2 Selia

Selia e shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Meçe Plast” sh.p.k është në adresën: Durrës, Lagjja 15, Spitalle, Zone Kadastrale 8517, Objekti me nr.pasurie 89/375/ND.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Meçe Plast” sh.p.k është pa afat nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKB.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Meçe Plast" sh.p.k është:
Tregtim i lëndes plastike dhe letres. Tregtimi, shit-blerjen me shumice dhe me pakice brenda dhe jashtë vendit. Import- Eksport te artikujve te ndryshem.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë "Meçe Plast" sh.p.k është 100,000 lekë dhe i përbërë nga 1 kuot sipas kontributit të ortakeve si më poshtë:

1. **Festim Meçe**, në masën 100% (Njeqind përqind)

Ky kapital do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të rregjistrohet në QKB

Kapitali fillestar është i nenshkruar dhe shlyer teresisht nga themeluesi, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar. Do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të rregjistrohet në Q.K.B.

Neni 6

Organet e Shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë "Meçe Plast" sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendimmarrës.
- Administrator është z. **Festim Meçe**.
- Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet.

Neni 7

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në Status që bashkë me Aktin e Themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

Neni 8

Veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statuti si dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me Gjykatë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e rregjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Meçe Plast " sh.p.k në QKB në këtë ditë shoqëria "Meçe Plast " sh.p.k njihet si person juridik.

Ortaku:
Festim Meçe

